




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 986/prot
1

Durrës, më 31.05.2019

V E N D I M

Nr. 8, datë 31.05.2019.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019,

V E N D O S I :

1. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, për ngritjen e grupeve të punës për aplikimet e projekteve kërkimore shkencore pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Tiranë, për fondet e vëna në dispozicion në lidhje me infrastrukturën fizike. Në këtë kuadër të merren masa për aplikimin e projekteve sipas afateve të përcaktuara.
2. Miratimin paraprak nga ana e Rektores, për çdo organizimin të eventeve, bashkëlidhur kërkesës për miratim të jetë dhe CV e personave të ftuar dhe axhenda e eventit.
3. Ngarkimin e Administratorit për përcjelljen në Bordin e Administrimit propozimin për menaxhimin e fondit bazë të kërkimit shkencor nga njësitë e UAMD-së.
4. Ngarkimi i Drejtorëve të Drejtorive dhe stafit të tyre për zbatimin me korrektësi të orarit zyrtar të punës.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi
 - Zv.Rektorët
 - Administratori
 - Dekanët e Fakulteteve
 - Drejtorët e Drejtorive
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

R E K T O R

Prof. Dr. Ksencela Sotirofski